



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 765/ 7 prot.

Datë 11/04/2025

V E N D I M
Nr. 487/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11/04/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BIBA-X” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-35889-01-23-2025, me objekt: “Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, me fond limit 249.470.651,69 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24.02.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

Ankimues:

Operatori ekonomik “BIBA-X” SHPK me NIPT K32618815N, dhe me adresë: Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50m pranë Karburant “EURODRIN”.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier
Adresa: Lagjja Kastriot, Rruga: "Ramiz Aranitasi", Fier.

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik “G.P.G. COMPANY” SHPK me NIPT J64324443V, dhe me adresë: *Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit AsfaltoBetonit, prane Rotondos se Plukut.*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “*Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.1.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-35889-01-23-2025, me objekt: “Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, me fond limit 249.470.651,69 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24.02.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

II.2. Në datën 24.02.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Më datë 11.03.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	“BIBA-X” ShPK	144.656.156,00	leke	skualifikuar
2	“G.P.G. COMPANY ” ShPK	165.098.873,00	leke	kualifikuar
3	“A.L-ASFALT ” ShPK	205.352.480,00	leke	skualifikuar
4	“ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK	217.039.407,60	leke	skualifikuar
5	“PE - VLA - KU” ShPK	219.380.534,00	leke	skualifikuar
6	“COGREN ShPK & JODY-KOMPANY ShPK & TEA-D ShPK”	230.803.002,00	leke	skualifikuar
7	“BEQIRI” ShPK	233.026.230,00	leke	kualifikuar
8	“C O L O M B O” ShPK	241.952.686,00	leke	skualifikuar

II.4. Në datën 11.03.2025, operatori ekonomik “BIBA-X” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës BIBA-X SHPK , me numër NUIS K32618815N, konstatoi mangësitë si më poshtë: Referuar Shtojcës 8, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.5, gërma “b”, përcaktohet se: “2.3.5 Operatori ekonomik duhet të këtë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion: b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë kapacitetet teknike si më poshtë: “Fabrikë asfaltobetoni - 1 copë – në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi. Shënim: Për pikën 2.3.5 (b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën të plotësuar rregullisht me të gjitha të dhënat e kërkuara për kualifikim në këtë pikë, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9. Ndërsa operatori ekonomik i

kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.5 (b), duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë: Për fabrikën e asfaltobetonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi dokumentin që vërteton pronësinë, Leje mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKL). Nëse fabrika e asfaltobetonit nuk është në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton posedimin e fabrikës (Kontratë qeraje e vlefshme, marreveshje furnizimi e vlefshme, etj.) e shoqeruar me dokumentin e pronësisë, dhe me Leje mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKL). Vendodhja e fabrikes duhet të jetë në një largësi jo më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit, pasi është parashikuar të shtrohen jo vetëm e rruget brenda qytetit të Fierit por edhe rrugë në njësitet administrative të Bashkisë Fier.” Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE: → shtojcen 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku ka deklaruar si më poshtë: Në pronësi 9.Fabrike asfaltobetonit me Leje mjedisore Kodi III.1.B Fature, Nr 294 Date 31.12.2011 → dokumentin me emërtimin “Fabrike_Asfalto-betonit_Biba-X_kavaje_(3)”, i cili ka në përmbajtje, ndër të tjera, lejen me kodin III.1.B, me datë lëshimi 20.03.2015, ku pasqyrohet adresa: Qarku: Tirane Rrethi: KAVAJE B/K: Lekaj Q/F: Adresa: Autostrada Durrës Rrogozhinë (50 m pranë karburant "Eurodrin") si dhe një dokument me emërtimin “DISTANCA E VENDODHJES SE IMPIANTIT TE ASFALTOBETONIT TE SHOQERISE BIBA – X NGA OBJEKTI I PROKURIMIT”, në të cilën pasqyrohet distanca nga fabrika e asfaltobetonit deri në qendrën e qytetit të Fierit prej 54.2 km. Referuar sa më lart, KVO, në bazë të të dhënave të mësipërme, bëri verifikimet për largësinë e kësaj fabrike nga qendra e qytetit të Fierit, ku rezulton se kjo fabrikë ndodhet në një largësi afërsisht 54 km nga qendra e qytetit të Fierit. Pra, ka një largësi më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit në kundërshtim me sa është kërkuar në kriterin 2.3.5, gërma “b”. Në këto kushte, rezulton që operatori ekonomik BIBA-X SHPK të skualifikohet për arsye të mospërmbushje të kriterit 2.3.5, gërma “b”. Gjithashtu, KVO konstaton se fabrika e asfaltobetonit e subjektit BIBA-X SHPK, rezulton të jetë e njëjta fabrikë për të cilën subjekti ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK ka lidhur kontratën e furnizimit me subjektin BIBA-X SHPK për këtë procedurë prokurimi, me të cilën subjekti ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK ka ofertuar si operator ekonomik më vete në këtë procedurë prokurimi, nga ku rezulton i skualifikuar për arsye se kjo fabrikë ndodhet në një largësi afërsisht 54 km nga qendra e qytetit të Fierit.”.

II.5. Më datë 19.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5166, datë 20.03.2025 dhe me numër protokolli nr. 765/2025 datë 20.03.2025 e operatorit ekonomik “BIBA-X” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-35889-01-23-2025, me objekt: “Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme

për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, me fond limit 249.470.651,69 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24.02.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “BIBA-X” ShPK, si dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “G.P.G. COMPANY” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 765/1 Prot, datë 21.03.2025, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “BIBA-X” ShPK, si dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “G.P.G. COMPANY” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “BIBA-X” SHPK ka paraqitur argumente, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 765/2 prot., datë 25.03.2025.

II.9. Në datë 02.04.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 930/19 prot, datë 02.04.2025 “*Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt: “Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier” me nr. REF-35889-01-23-2025*”, protokolluar me tonën me nr. 765 prot, datë 02.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “BIBA-X” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “BIBA-X” SHPK mbi kundërshtimin e e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me pretendimin se: “Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE: → shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku ka deklaruar si më poshtë: Në pronësi 9.Fabrike asfaltobetoni me Leje mjedisore Kodi III.1.B Fature, Nr 294 Date 31.12.2011 → dokumentin me emërtimin “Fabrike_Asfalto-betoni_Biba-X_kavaje_(3)”, i cili ka në përmbajtje, ndër të tjera, lejen me kodin III.1.B, me datë lëshimi 20.03.2015, ku pasqyrohet adresa: Qarku: Tirane Rrethi: KAVAJE B/K: Lekaj Q/F: Adresa: Autostrada Durrës Rrogozhinë (50 m pranë karburant "Eurodrin") si dhe një dokument me emërtimin “DISTANCA E VENDODHJES SE IMPIANTIT TE ASFALTOBETONIT TE SHOQERISE BIBA – X NGA OBJEKTI I PROKURIMIT”, në të cilën pasqyrohet distanca nga fabrika e asfaltobetonit deri në qendrën e qytetit të Fierit prej 54.2 km. Referuar sa më lart, KVO, në bazë të të dhënave të mësipërme, bëri verifikimet për largësinë e kësaj fabrike nga qendra e qytetit të Fierit, ku rezulton se kjo fabrikë ndodhet në një largësi afërsisht 54 km nga qendra e qytetit të Fierit. Pra, ka një largësi më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit në kundërshtim me sa është kërkuar në kriterin 2.3.5, gërma “b”. Në këto kushte, rezulton që operatori ekonomik BIBA-X SHPK të skualifikohet për arsye të mospërmbushje të kriterit 2.3.5, gërma “b”. Gjithashtu, KVO konstaton se fabrika e asfaltobetonit e subjektit BIBA-X SHPK, rezulton të jetë e njëjta fabrikë për të cilën subjekti ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK ka lidhur kontratën e furnizimit me subjektin BIBA-X SHPK për këtë procedure prokurimi, me të cilën subjekti ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK ka ofertuar si operator ekonomik më vete në këtë procedure prokurimi, nga ku rezulton i skualifikuar për arsye se kjo fabrikë ndodhet në një largësi afërsisht 54 km nga qendra e qytetit të Fierit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT ” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion:

a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9):

Lista e Makinerive: Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirembajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier					
NR	EMERTIMI I MAKINERISE	SPECIALIST MAKINERISH	NR I MAKINERIVE	SHENIME	Statusi
1	Asfaltoshtruese	Buldozerist	1	Per zerin 1,2	Me pronesi ose me qira ose sipas

					legjislacionit ne fuqi
2	Autobitumatriçe	Automakinist	1	Per zerin 1,2	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit ne fuqi
3	Rul (kompresor) me vibrim	Buldozerist	2	Per zerin 1,2,3	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit ne fuqi
4	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtes nen 10 ton per transportin e materialit ne rruget e shesheve te lagjeve te cilat jane te ngushta	Shofer me leje drejtimi C	2	Per zerin 1,2,3	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit ne fuqi
5	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Shofer me leje drejtimi C	2	Per zerin 1,2,3	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit ne fuqi
6	Autobot	Automakinist	1	Per zerin 3	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit
7	Grejder	Buldozerist	1	Per zerin 3	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit

Shënim:

Për pikën 2.3.5 (a) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.5 (a), duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- i. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.**
 - ii. Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerase, e vlefshme.**
 - iii. Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
 - iv. Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- b)** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë kapacitetet teknike si më poshtë:

Fabrikë asfaltbetoni - 1 copë – në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi.

Shënim: Për pikën 2.3.5 **(b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën të plotësuar rregullisht me të gjitha të dhënat e kërkuara për kualifikim në këtë pikë, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.5 **(b)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për fabrikën e asfaltbetonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi dokumentin që vërteton pronesinë, Leje mjedisore me kod III.1.B (leshuar nga QKL).

Nëse **fabrika e asfaltbetonit** nuk është në pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton posedimin e fabrikës (Kontrate qeraje e vlefshme, marreveshje furnizimi e vlefshme, etj.) e shoqëruar me dokumentin e pronesisë, dhe me Leje mjedisore me kod III.1.B (leshuar nga QKL).

Vendodhja e fabrikës duhet të jetë në një largësi jo më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit, pasi është parashikuar të shtrohen jo vetëm e rruget brenda qytetit të Fierit por edhe rrugë në njësitet administrative të Bashkisë Fier.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme, nëse e gjykon të arsyeshme, mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar).

III.1.2. Në shtojcën 9 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, "Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit", B: "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)", ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____
--

III.1.3. Në shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.1/a “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9

III.1.4. Në shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi në dokumentin e emërtuar “*lista e rrugëve 2025*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar vendodhjen e rrugëve dhe shesheve për të cilat operatori ekonomik i suksesshëm do të realizojë furnizimi, transporti dhe realizimi i shtresave përkatëse në këto objekte (rrugë dhe sheshe) me mjetet dhe pajisjet e tij, si më poshtë vijon:

LISTA E RRUGEVE DHE SHESHEVE (SHTESE) PRIORITETI		
Nr.	Emertimi i rruges	Adresa
NJESIA ADMINISTRATIVE LEVAN		
1	Rruga e Gjellajve	Fshati Ferras
2	Rruga Rustem Bidaj	Fshati Bashkim
NJESIA ADMINISTRATIVE PORTEZ		
1	Rruga me emertimin "Shaqir Elmazi"	Fshati Portez
2	Rruga kryesore e fshatit Lalar	Fshati Lalar
NJESIA ADMINISTRATIVE CAKRAN		
1	Rruga Shahaj	Fshati Cakran
2	Rruga Unaza e Re Cakran	Fshati Cakran
NJESIA ADMINISTRATIVE NR.1		
1	Sistemimi i sheshit tek Pediatria	L. 1 Maji
NJESIA ADMINISTRATIVE MBROSTAR		
1	Rruga kryesore e fshatit Petove (nga shkolla drejt Libofshes)	Fshati Petove
NJESIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHE		
1	Rruga kryesore e fshatit Agim	Fshati Agim

III.1.5. Për përmbushjen e kriterit kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.3.5 gërma “b” “Kapaciteti teknik” të Shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*”, operatori ekonomik ofertues “AlbaScan” SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, si më poshtë vijon:

- Shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, i vulosur dhe i firmosur nga administratori i shoqërisë, ku në Seksionin B “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka deklaruar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje										
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:										
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Profili i punonjësve</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Lloji i Mjetit</th><th>Targa</th><th>Nr. Lejes qarkullimit</th><th>Nr. Shasisë</th><th>Të tjera</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>9. Fabrike asfaltobetoni me Leje mjedisore Kodi III.1.B</td><td></td><td></td><td></td><td>Fature, Nr XXX Date XX.XX.XXXX</td></tr> </tbody> </table>	Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera	9. Fabrike asfaltobetoni me Leje mjedisore Kodi III.1.B				Fature, Nr XXX Date XX.XX.XXXX
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera							
9. Fabrike asfaltobetoni me Leje mjedisore Kodi III.1.B				Fature, Nr XXX Date XX.XX.XXXX							

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

- Kontratë shitje pasurie të pajuajtshme, datë XX.XX.XXXX, me shitës shoqërinë “XXX” SHPK dhe blerës shoqërinë “BIBA-X” SHPK, përfaqësuar nga administratori z. Barush Biba, me objekt: “Fabrikë Asfaltobetoni”, me vlerë XXX leke, shoqëruar me dukumentacionin si më poshtë

- Faturën tatimore të shitjes me numër serial: XXXXXXXX, datë XX.XX.XXXX, me shitës shoqërinë “XXX” SHPK dhe blerës shoqërinë “BIBA-X” SHPK, me objekt: “Fabrikë Asfaltobetoni”, me vlerë XX.XXX.XXX leke.

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, për llojin e pasurisë “Arë” me sipërfaqe xxxx m2, me vendodhje Shtodher, në bashkpronësi të z. X.X, z. X.X dhe z. X.X.

- Certifikatë ISO 9001:2015, me numër: XXX, lëshuar në datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.XXXX, për subjektin “BIBA-X” SHPK, me adresë: “Fshati Kryeluzaj, Pika inerte 50 m, pranë karburantit Eurodrin, Lekaj, Harizaj, Tiranë”, me objekt veprimtarie: “Projektimi, ndertimi dhe montimi, restaurimi dhe mirembajja e punimeve civile dhe industriale (rruge, ura, ujesjellsa, kanalizime, punime elektrike, punime sinjalistike dhe siguri rugore, gjelberim). Projektimi, ndertimi dhe mirembajja e veprave elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë. Dhenie mjetesh të ndryshme me qira. Krijimi dhe mirembajtja e hapësirave të gjelberta publike dhe private. Prodhimi dhe tregtimi i inerteve dhe produkteve bituminoze asfaltbetoni dhe beton për ndertim. Prodhimi dhe tregtimi i bordurave anësore prej betoni, tubave prej betoni, pusetave, pllakave të trotuarit dhe blloqeve të betonit.”.

- Leje Mjedisë Tipi B, numër: XXXX, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit më datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie “Pa afat”, për subjektin “BIBA-X” SHPK, për veprimtarinë: “Leje mjedisë e tipit B për aktivitetin: Perzjerja e cimentos ose përdorimi i cimentos në mase të mëdha, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe perzjerjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të cimentos. Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të jera minerale jo metalike. eprimtarite që përfshijnë ngrohjen, por 10 distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi. Riparim dhe mirembajje e makinerive dhe pajisjeve.”, me vend të ushtrimit të aktivitetit në adresën: “Qarku; Tiranë, Rrethi: Kavajë, B/K: Lekaj Q/F: Adresa: Autostrada Durrës-Rrogozhinë (50 m pranë karburant “Eurodrini”)”.

- Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B nr: XXXX, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për personin juridik “BIBA-X” SHPK, me adresë: “Fshati Kryeluzaj, Pika inerte 50 m pranë karburant “EURODRIN”, Harizaj, Lekaj, Kavajë, Tiranë.”.

- Dokumenti “Distanca e vendodhjes së impiantit të asfaltobetonit të shoqërisë “BIBA-X” nga objekti i prokurimit”.

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.1.9. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht :

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të

kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës,

- sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h” “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme

për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.1/a dhe 2.3.5/b të kriterëve të veçanta të kualifikimit lidhur me disponimin e një fabrike asfaltobetonit me leje mjedisore të Kodit III.1.B, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues “BIBA-X” ShPK ka dorëzuar Shtojcën 9 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të firmosur nga administratori shoqërisë, ku deklarinimet e bëra në këtë shtojcë në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor i pranon si prova paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues “BIBA-X” SHPK, për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5/b “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka dorëzuar Shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” duke deklaruar se ka në pronësi një fabrikë asfaltobetoni, si dhe ka paraqitur dokumentacionin që vërteton pronësinë e kësaj fabrike të përmendur në pikën III.1.5. të këtij vendimi.

Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”**. Gjithashtu, nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Autoriteti kontraktor nuk i ka kërkuar ofertuesit “BIBA-X” SHPK dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjën “i” pika 2 e nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: ***“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon :[...] i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”, për arritjen në një përfundim të saktë, që operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5/b “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi lidhur me disponimin e një fabrike asfaltobetoni me leje mjedisore të Kodit III.1.B, por në tejkalim të këtyre parashikimeve ligjore ka marrë në shqyrtim dokumentacionin si në vijim: “Kontratën e shitjes së pasurisë të pajuajtshme, datë XX.XX.XXXX, Faturën tatimore të shitjes me numër serial: XXXXXXXX, datë XX.XX.XXXX, Certifikatën për vërtetim pronësie, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, Certifikatën ISO 9001:2015, me numër: XXX, lëshuar në datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.XXXX, Lejen e Mjedisit Tipi B, numër: XXX, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit më datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie “Pa afat”, Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B nr: XXXX, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Agjencia***

Kombëtare e Mjedisit dhe Dokumentin “Distanca e vendodhjes së impiantit të asfaltobetonit të shoqërisë “BIBA-X” nga objekti i prokurimit”.

Gjithashtu, sipas shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklarata do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.**

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, objekt - ankimi, duhet t’i referohet shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike** dhe jo dokumentave si në vijim: “Kontratën e shitjes së pasurisë të pajuaftshme, datë XX.XX.XXXX, Faturën tatimore të shitjes me numër serial: XXXXXXXX, datë XX.XX.XXXX, Certifikatën për vërtetim pronësie, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, Certifikatën ISO 9001:2015, me numër: XXX, lëshuar në datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.XXXX, Lejen e Mjedisit Tipi B, numër: XXX, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit më datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie “Pa afat”, Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B nr: XXXX, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Dokumentin “Distanca e vendodhjes së impiantit të asfaltobetonit të shoqërisë “BIBA-X” nga objekti i prokurimit”. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në

përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtyre kapaciteteve, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë kërkuar paraqitjen e dokumentacionit fizik për vërtetimin e deklaramit të bërë nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5/b “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe vetëm pas paraqitjes së këtij dokumentacioni autoritetit kontraktor i lind e drejta për të bërë verifikimet pëkatëse. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatori ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,** si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.5/b “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për disponimin e një fabrike asfaltbetoni me leje mjedisore të Kodit III.1.B si më sipërcituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Shtojcën 9 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” në të cilit ka deklaruar se një fabrikë asfaltbetoni. Në kriteret kualifikuese nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar shprehimisht se fabrika e asfaltbetonit nuk duhet të jetë në një

distancë më të largët se 50 kilometra nga vendodhja e objektit të prokurimit, ku referuar dokumentit të emërtuar “lista e rrugëve 2025” objekti i prokurimit ka disa vendodhje dhe konkretisht si në vijim: *“Fshati Ferras, Fshati Bashkim, Fshati Portez, Fshati Lalar, Fshati Cakran, L. 1 Maji, Fshati Petove dhe Fshati Agim.”*, ndërkohë që autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar se për cilën nga këto vendodhje do të llogaritet distanca prej 50 kilometrash.

Pra në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në dokumentet e tenderit pikën takuese midis kufirit maksimal të territorit të Bashkisë Fier dhe pikës së propozuar të prodhimit të asfaltobetonit, AK, në cilësinë edhe të organit të pushtetit vendor që disponon hartat e qeverisjes vendore të territorit të tij, duhet të marrë masa, në kuadër të një procesi transparent, të kërkojë sqarime nga ankimesi si dhe të kryejë verifikimet përkatëse të distancës konkrete, në përputhje me nenin 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të thejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”*.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “BIBA-X” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BIBA-X” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-35889-01-23-2025, me objekt: *“Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”* me fond limit 249.470.651,69 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24.02.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

1. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
 2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BIBA-X” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

